



Planuar / Doretuar Prindjen/Predata Received/Delivety	13.04.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	H/Prot H/Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	1736/2021		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.179/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.179/2021 të datës 24.03.2021 të parashtruar nga ankuesi, me adresë Rruga: "Prizrenit", Fshati Llashkabarë, në Komunën e Ferizajt, kundër organit të punësimit Inspektorati Policor i Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.179/2021, të datës 24.03.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, ka aplikuar në konkursin e brendshëm të datës 27.10.2020 për pozitën "Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës" në Inspektoratin Policor të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme. Konkursi për pozitën "Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës" ka qenë i hapur për aplikim nga data 27.10.2020 deri më 10.11.2020.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 31.12.2020, me datë 29.01.2021, parashtron ankesë në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, me datë 25.02.2021 nxjerr vendimin Nr.0041/2021, me të cilin e shpall veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit. Ankuesi me datë 24.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1350/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 26.03.2021, me numër protokoli 1422/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Inspektorati Policor i Kosovës, ndërsa me datën 01.04.2021 me numër protokoli 1525/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Ankuesi, më datë 02.04.2021 ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kërkesë me numër protokoli 1597/2021 për tërheqjen e ankesës së



datës 24.03.2021 me numër protokoll 1350/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokoll 1350/2021 e datës 24.03.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Inspektoratin Policor të Kosovës, i datës 27.10.2020; Emalin zyrtar të datës 17.12.2020; Emalin zyrtar të datës 29.12.2020; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 31.12.2020; Emalin zyrtar të datës 30.12.2020; Ankesa e ankuesit drejtuar Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, e datës 29.01.2021; Vendimin e Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë Nr.0041/2021, i datës 25.02.2021; Kërkesën për përgjigje të datës 26.03.2021; Kërkesën për tërheqjen e ankesës të datës 02.04.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 01.04.2021;


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi, më datë 24.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1350/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 02.04.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll 1597/2021 për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe pas analizimit të tërheqjes së ankesës nga ana e ankuesit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e ankuesit e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.179/2021.

Hysni Mustafa

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

